

Dëmtimet e paqëllimshme, aksidentet dhe traumat.

Dëmtimet e paqëllimshme vijnë si pasojë e aksideneteve, traumave, helmimeve dhe plagosjeve të rastësishme e të pavullnetshme.

Aksidentet dhe traumat ndodhin rëndom në të gjitha situatat e jetës; në punë, shtëpi, shkollë, në vënde argëtimi si dhe në trafikun rrugor.

Këto dëmtime sjellin si pasojë lëndime e plagosje të rënda dhe në shumë raste edhe humbjen e jetës.

Në Shqipëri sipas INSTAT, vdekjet për shkaqe të jashme, jo natyrore (ketu futen edhe dëmtimet aksidentale jo të vullnetëshme) janë vrasësit më të mëdhenj në moshat 5-45 vjeç.

Aksidentet në vëndin e punës përbëjnë një shkak serioz për sëmundje dhe paaftësi dhe janë të parandalueshëm në një numër të madh rastesh.

Djegjet dhe rrezimet aksidentale, demtimet nga municionet e paplasura, perbejne shkaqe te tjera per demtimin e shendetit ndaj te cilave duhet treguar kujdes i vazhdueshem pasi eshte mundesia te parandalohen.

Dëmtimet nga traumat rrugore janë të shumta dhe janë gjithashtu të parandalueshme, në rast se i kushtohet vëmëndja e duhur vendosjes së rripit të sigurimit, përmirësimit të cilësisë së rrugëve e të sinjalistikës rrugore, kufizimit të shpejtësisë, si dhe rritja e masave shtrënguese për drejtuesit që nuk zbatojnë rregullat e qarkullimit rrugor, që përdorin alkolin, celularin gjatë përdorimit të mjetit.

Reduktimi i ndjeshëm i rrezikut ndaj ngjarjeve të tilla, si dhe zvogëlimi në total i shifrave të të plagosurve e të vdekurve nga shkaqet jo natyrore, mbetet prioritet i punës për shendetin publik.

Spektori shendetesor luan nje rol te rëndesishem jo vetem nepermjet sigurimit te kujdesit per viktimat, por gjithashtu edhe nepermjet parandalimit dhe promovimit shendetesor, te cilat jane ne qender te aktiviteve te shendetit publik, pa harruar edhe partneritetin me sektore te tjere publike dhe private dhe me te gjitha nivelet qeveritare.